



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

**Legjislatura VIII**

**Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere**  
**Mbledhja nr.22/24**  
**Prishtinë, më 21.11.2024, në orën 9:30**  
**Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203**

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mërgim Lushtaku, Enver Haliti, Jeta Statovci, Nijazi Isaku, Shqipe Meta, Duda Balje.

**Munguan:** Ferat Shala, Avdullah Hoti, Pal Lekaj.

**I ftuar:**

**Pjesëmarrësit tjerë,** Eva Buqaj, monitoruese, KDI; Sami Gashi, GP-LVV, Elsa Krasniqi, GP-LVV; Festim Bytyçi, këshilltar, GP-AAK; Nexhmije Ahmeti, zyrtare e mediave, Kuvendi i Kosovës; Anduena Shtavica, asistente e deputetit të GP LDK; Egzona Tërdevci, këshilltare, LVV.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli; Frina Kabashi, praktikante –D+.

## **Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;**
- 3. Të ndryshme.**

## **2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut;**

Projektligji nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, është shqyrtuar nga Komisioni funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i cili komision ka dërguar raport me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon te Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i **Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut**, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore, të paraparë me Ligjin nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës (për vitin 2023), si dhe vlerësimeve për vitet 2024-2025 për MINT, përkatësisht për nënprogramin e Inspektoratit të Tregut, si zbatues i këtij projektligji.

## **R e k o m a n d i m:**

1. Projektligji nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut nuk përmban kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, për Projektligjin nr.08/L-279 për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

### 3. Të ndryshme

**Kryetari**, pyeti anëtarët e komisionit, se a kanë ndonjë çështje për të ngritur në këtë pikë?

Lidhur me këtë pikë, nuk pati ndonjë çështje për t'u ngritur.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

**Kryetar i komisionit,**

---

**Armend Muja**